

# Oral History Kosovo

---

**Narratorja:** Mas lindjes të djalit unë kom pasë probleme shumë të mëdhaja shëndetësore edhe nuk e kom pasë përkrahjen e burrit, as të familjes tina. Kemi jetu me prindët e tina edhe me burrin.

**Intervistuesja:** Ku?

**Narratorja:** Në Prishtinë. Edhe masi e kom lindë djalin kom pasë probleme të vazhdushme. Probleme që kanë fillu prej shtatzanisë ama që jonë kanë ma të dukshme jonë kanë mas lindjes djalit.

**Intervistuesja:** Çfarë lloj probleme kanë qenë?

**Narratorja:** Po nashta gjatë shtatzanisë ma shumë jo. Do fjalë e do... psiqikisht kësi gjana, se dhunë fizike s'kom pasë asniherë. Kurrë. Po kanihere shumë ma shumë dhem qajo psiqikisht se... ma shumë dhem ni fjalë, se me ta dhonë shuplakë. Për shembull, s'kom pasë drejtë me bo plane kurgjo me burrë tem, se gjithmonë u dashtë m'u vet motra e tij e martume, a duna me bo a s'duna me bo? Nëse une e kom bo ni plan, e kena bo në fakt ni plan edhe ai plani gjithmonë ka dështu. Kështu që, problemet ma të mëdhaja kanë ndodhë mas lindjes kom pasë probleme. Unë kom pasë probleme shëndetësore e që si pasojë e moskujdesit tyne shumë, po e thomë shumë ma drejtë, nuk më kanë leju me shku te mjeku.

**Intervistuesja:** Për çfarë arsye?

**Narratorja:** Se demek, "Veç po shtihohet kjo, s'ka kurgjo. Krejt kemi lindë, krejt kemi pasë dhimbje. Kemi pasë kësi, kemi pasë ashtu". Edhe...

**Intervistuesja:** Ma saktësisht ka qenë depresion mas lindjes?

**Narratorja:** Jo, kom pasë absces në gji. Prej të cilit mu më kanë thonë se osht' bo kancer. E që nuk më kanë lonë me shku te mjeku me trajtu me kohë edhe osht' bo bajagi e madhe. Kur unë kom fillu me shku te mjeku, nëse nuk gaboj, i ka pasë djali dy javë. Masi i ka bo djali dy javë e kom pa që këta nuk po

insi... nuk po... unë insistojsa me shku te mjeku edhe tonë kohën me ato se, “Kalon krejt, te gjithkush ndodh kjo. Kalon edhe kjo”. Edhe unë kom insistu me m’çu te baba jem. Jo me m’çu m’u nda, po kom thonë, “Jom e mërztun po du me shku me nejt pak”. Edhe okej, e ka vetë nonën e vet, ajo i ka thonë, “Ço!” Më ka çu te baba jem. Edhe atë natë kur kom shku te baba jem më ka hup vetëdija. Edhe masanej vëllau jem e ka thirrë në telefon edhe i ka tregu qysh osht’ gjendja jeme. Edhe i ka thonë se, “Nëse nuk vjen ti me çu te mjeku se e ki gru edhe në çfarë gjendje e ke pru e çojmë na”. Po ka ardhë më ka çu te mjeku.

Kur jemi shku në qendrën e mjekësisë familjare, ata na kanë udhëzu direkt për spital. Edhe në spital e kom pasë menjëherë ndërhyrjen e parë. Gjithçka ka ndodhë qaty pa anestezion, pa kurgjo, se u konë komplet trupi i musht me kelb. Edhe më kanë thonë, “Edhe nëse të jepim anestezion nuk munet me të pi”. Kështu që, krejt ato premjet, ato jonë bo pa u pi. Edhe fjalët e doktorit, “Osht’ dashtë me pru ma herët, jo me lonë dej këtë gjendje. Po Zoti paska dashtë e ke pru, se ka mujt me vdekë krejt. Se jonë konë t’u ju helmu krejt organet e trupit”. Mas pesë jave është dashtë me i bo analizat ma të thella, ku më ka thonë se, “Ki kancer të gjirit edhe duhet me hi me bo operim me hekë gjinin”. Domethonë, jom konë në javën e katërt trajtimit kur jemi nda.

**Intervistuesja:** Javën e katërt të kujt?

**Narratorja:** Të mjekimit, kur jemi nda. Jom çu në mëngjes jom shku te mjeku, ka pasë me m’i kepë varrët që i kom pasë hapun, për ka tri javë të hapne. Edhe kepja u bo pa anestezion edhe jom kthy prapë në banesë. E kemi hongër drekën e Bajramit edhe mirë gjithçka u konë normale. Masandej prindët e burrit kanë shku te prindët e vet me bo Bajram. Edhe mu më kanë thirrë familja jem, më ka thirrë vëllau, më ka thonë që, “Po dojna me ardhë me bo Bajram”. Krejt ka fillu qitu.

Unë jom hi i kom tregu burrit që më ka thonë qishtu edhe, “Okej, në rregull” edhe kom dalë në dhomë te djali. Masanej motra vet ka ndiku pak. Kur kom hy e kom pa që jonë t’u fol, kom thonë, “Çka po ndodhë?” “S’kanë çka me lyp ata me ardhë, pse me ardhë kur s’jonë prindët e mi këtu? Ti zojë shpije këtu s’je. Ku guxon me pru ti familjen tone pa konë nona jem këtu”. Edhe fillunë këto gjanat, fillunë m’u kapë për sene shumë palidhje, për kurgjo hiç.

Nuk kom pasë qef me pasë konflikt mes familjeve. Se familjarët e mi i kanë respektu shumë edhe kom pasë qef me pasë, me majt qet raport gjithmonë. Pavarësisht çka ka ndodhë, nuk kom pasë qef problemet me burrë tem me ja shfaq familjes tem. Kom dashtë gjithmonë me respektu, me dashtë qysh e kanë dashtë.

**Intervistuesja:** A ke folë najhere me dikon?

**Narratorja:** Jo, kurrë. Asniherë. Edhe i kom shkru vëllaut tem, i kom thonë, “Mos hajdeni, s’i ka prindët këtu”. Edhe burri osht’ nervozu pak, “Pse i shkrujtë?” Thashë, “Po qishtu ti po ma përzen familjen tem”

thashë, “kjo osht’ shumë normale, sikur me të ardhë në derë me ja mbyll derën, sikur me ju thonë, ‘Mos m’hajde’”. Thashë, “Edhe ai nuk të tha që po vi meniherë, veç tha që, ‘Kemi me ardhë’”. Thashë, “Unë s’po kuptoj për çka, çka osht’ t’u ndodhë? Nuk jonë familje që të vijne tanë kohën”. Realisht nuk jonë familje që i shkojnë pa lajmëru dikujt, se nëse ishin konë ashtu nashta edhe vet e kisha pa të arsyshme. Po, pavarësisht prindët kurrë nuk jonë të tepërt.

Edhe thashë, “Ke normale” thashë, “po s’ka dert, ju” thashë, “vendosni” thashë, “çka boni nëpër shpija të juve, atëherë ju vendosni. S’kom çka me ba!” Edhe jom çu kom hi në dhomë edhe prej inati që ja kom kthy fjalën motrës tina erdhi në dhomë qaty filloi konflikti pak ma i madh. Masanej më thirri vëllau jem, unë jom konë t’u kajt edhe kur më ka thirrë unë i kom tregu gjithçka në telefon. Kur kanë ardhë prindët e tij, mu më erdh marre me dalë me thonë që qishtu ka ndodhë. Jom bajagi nifarë tipi i marrushëm. Edhe shkova u ula, u munojsha, qysh me marrë atë guximin me dalë edhe me i thonë qishtu ka ndodhë.

Derisa dikur e disha që nëse s’i thom une, ka me i thirrë vëllau jem. Edhe u ula i thashë, thashë, “Babë” thashë, “më duhet me diskutu diçka me ty nëse ka mundësi?” Thashë, po i tregoj, thashë, “Deshtën me ardhë familja jem” thashë, “nuk kenë të pajtimit”. Po i tregoj qysh ndodhi gjithçka edhe ke shtrinë u çu u ulë edhe më tregoi tha, “Unë prej fillimit kom qenë kundër lidhjes ju”. Edhe e kom respektu shumë, nuk muj me thonë që e kom dashtë si babën tem, se s’muj me dashtë kërkon si babën tem, amo muj me thonë se 80 përqind e kom dashtë si babën tem. I vetmi njeri nashta që kur e kom ni tu u kullë në dhomën tjetër s’kom mujtë me nejt ulun.

E kom respektu, kom pasë shumë respekt për to. Kur ma ka thonë atë fjalë, nuk e di, s’muj me thonë që jom befasu, amo më ka shoku. Edhe kom thonë, “Pse çka ka ndodhë? Çka je kundër meje? Pse je konë kundër lidhjes tonë?” Thashë, “U kry veç po du me ditë qeto, se po kom qefë me i sqaru qeto gjana që me pasë ni jetë të rahatshme, se po e shoh që s’e kom jetën e rahatshme. Çka ka kundër? Pse je konë kundër?” “Jo” tha, “mos u prek se s’kom kurgjo kundër teje. E shoh që je e mirë, e sjellshme, thjeshtë jom konë kundër lidhjes”. “Po, pse kundër lidhjes? A ki diçka kundër babës tem?” Se ma ka njoft babën.

“Jo, Zoti mos e boftë. Une gjithmonë kom thonë e keni fatin me pasë vajzën e tij në shpi”. “E çka kundër?” Thashë, “S’po kuptoj”. “Veç” tha, “kom pasë qef që djali jem me marrë ni femën të shkollume edhe të punësime”. “Okej” thashë, “une e shkollume jom, fakultetin e kom të përfundun, e punën tash s’e kom” thashë, “na u martum, u bana nanë, tash s’mujtën m’u bo krejt senet përneherë”. Mu realisht më preki qajo fjalë, se djali i tij i kish dy fakulteta të përfundum po ish i papunë. Nuk e kuptojsha pse, pse gjithmonë synimi osht’ veç femra duhet me punu, me majt familjen, a duhet edhe mashkulli për familje. Une kuptoj femra duhet me punu për me përkrah burrin, amo nuk e ka për obligim me majt familjen.

Prej aty që e bonëm qat muhabet me babën e tij, “Mu” tha, “s’më ke pëlqy asniherë”. “Okej” thashë, “para se me u feju une me djalin e juve edhe para se me pasë ni raport shumë ma të madh” thashë, “na

jemi pa edhe nëse veç lidhja jonë ndikohet prej fjalëve të juve, ju osht' dashtë atëherë me thonë, 'Nuk po na pëlqen, nuk osht' e përshtatshme për shpinë tonë.' Thashë, "Une shumë thjeshtë isha tërhjekë". Thashë, "Këto veç po du me ja u bo me dije, mos e merrni në qafë kërkon", thashë, "se ju shumë sene m'i keni stopu në jetë me qeto". Edhe masanena ja filloi tha, tha, "Merri" tha, "teshat e sajna, hiqma prej shpisë" tha, "se s'po du me pa" tha, "unë ta gjej ty njo tjetër hala ma të mirë".

"Okej" thashë, "në rregull, pasni vendos domethonë a?" Thashë, "Te na thojnë, ra kjo deké e u pamë. E tash unë po thom, ra qekjo situatë e p'e shoh ku e pasna pasë venin", thashë, "ose ma saktë që s'pasna pasë vend në këtë familje. As s'pasna pasë me bo kurrë ven në këtë familje, sado që jom mundu". Edhe kom keshë, realisht kom keshë. Edhe motra tina ma ka bo, tha, "Kjo" tha, "s'osht' mirë se edhe po keshë". Edhe jom çu prej aty jom dalë, jom shku në dhomë teme edhe jom ulë kom nejt, se e kom marrë që jonë acaru edhe kanë fol palidhje, s'jonë t'u ditë as çka janë t'u fol. Edhe kur kom shku në dhomë e kom ni nanën e tij tu ja bo, "Krejt çka ka, as çerapë të sajna s'du me m'u sjellë këtu, hiqmi, hiqmi. Meniherë me m'i hekë prej këtuhi!".

Edhe ka ardhë ka thonë, "Boni teshat gati edhe po të çoj te baba jot". I kom thonë, "Okej, a po don me më çu te baba jem?" "Po", "A ki arsye ti çka i thu babës tem, për çka?" "Veç i thom që s'po na ecë", "Po ti s'munesh m'i thonë babës tem s'po më ecë, se deri tash të ka ecë. Qysh tash s'po të ecë?" Edhe unë po ju thom atyne, thashë, "A ka mundësi me prit për vëllaun tem deri sa vjen te shpia?" Thashë, "Baba osht' vet" thashë, "s'po du, le të shkon ai me i pregaditë pak". "Jo, jo hajde, hajde, meniherë, meniherë!" "Okej", u çova une e mora çantën edhe ai u kthy i tha nanës të vet, "A me ja lonë pampersat e djalit, a mos me ja lonë?" E kish ni komplet pampers që ja blejti qat ditë. Tash, a me mi dhanë mu me veti a jo? Ajo tha, "Jepja, jepja, jepja se le t'i merr".

Kom ecë, kom shku te prindët e mi. Kom shku jom hi, baba u konë veç vet, veç me motrën e vogël. Nashta prej krejt kësajna qai u konë momenti ma i fshtirë. Kur jom hi, ata kanë nejt te dera, baba i tina edhe ish burri jem edhe e thirrën me dalë jashtë babën tem. Une jom hi mrenda, kur jom hi baba si më sheh me djalë çohet i hap durët, "A kush më ka ardhë" prej gëzimit po na kapë përqafe. Si më ka kap përqafe, unë ja kom nisë me kajt meniherë. Si më ka pa t'u kajt e ka ditë që diçka ka ndodhë. "Çka u bo?" Veç ja kom bo... s'kom mujt me fol. Edhe t'u ja bo, "Po të presin jashtë". "Jo" tha, "s'dalë pa më tregu ti çka ki. Për mu ti je e rëndësishme, s'o i rëndësishëm kush osht' jashtë. Ti je me rëndësi, çka u bo? Qetësohu".

Edhe jom nalë pak jom mundu m'u qetësu, po mu dridhke zoni edhe s'mujsha me ja tregu senet tamam kthjellët. Edhe thashë, "Babë" thashë, "qishtu osht' puna, jonë tu të pritë jashtë, s'po muj me ta spjegu ma shumë, po a po del jashtë?" Thashë, "Se ata janë tu të pritë e të tregojnë ata" thashë, "nëse veç të tregojnë". "Okej". Edhe u dalë baba jem, "Ani" tha, "qetësohu ti ta marrë unë djalin". Edhe u dalë baba, kur u dalë baba mixha u konë tu i përcjellë do musafirë. Edhe baba jem ju ka thonë, "Çka osht' problemi?" Ai ka thonë, "Ta kom pru çikën", "Po unë e pashë që ma ke pru çikën, po për çka e prutë çikën? A e prutë me bo Bajram, a çka?"

“Jo, jo, s’osht’ punë Bajrami”, baba i tina. “Fol ti me çikën tone” edhe nuk i spjeron kështu diçka. Edhe baba jem thotë, “Okej”, thotë, “une foli me çikën teme, po vetëm diçka po ju thomë, po du me ju bo me dije kom me lut Zotin natë e ditë veç ni grimë faj me pasë çika jem, po tu e ditë une farë fëmije e kom nuk ka faj. Une lutna me konë faji te kjo e mos m’u bo diçka e madhe. Veç po ju thom, shtrengone mirë konopin se s’e dini qysh ka me ju kërsitë”. Masanej erdhën vëllau, nana, motrat edhe po ju tregoj, p’i tregoj motrës qishtu qishtu. Motra tha, “Tregoji babit krejt”. Thashë, “Nuk e di a kom me mujt” thashë, “për qata po flas me ty” thashë, “se unë e di që kur dalë para babit” thashë, “nuk kom me mujt me fol” thashë, “se s’ka me më dalë zoni”. “Ani” tha, “mos e kqyr babën” tha, “po ti fol krejt çka ki me to”.

Masanej ditën tjetër i tregova babës tem, u ula, nashta Zoti i madh më ndihmoi edhe fola pa pikë problemi, deri në fund e përfundova krejt. “Okej” tha, “ne rregull” tha, “e djali?” Thashë, “Djali i jemi osht”, “Une p’e kuptoj” tha, “që osht i yti” tha, “osht’ nipi jem” tha, “po çka të thanë për djalë?” Thashë, “Jo s’më thanë kurgjo. Veç më thanë, ‘Merre djalin’”. Tha, “A nuk të thanë, ‘Leje djalin e ti shko?’”. Thashë, “Jo”, “Hiç, hiç kurgjo?” Thashë, “Jo”. “E çka, as s’e kapën përqafe bile?” “Po” thashë, “le ata, po as baba i vet diqysh as s’e kqyri, as s’e kapi përqafe”. “Hiç”. Tha, “S’ki çka më kallxon ma shumë”.

Dy mujë ai nuk ka ditë kurgjo për djalë, hiç. Edhe pse kohë pas kohe ja çojsha naj foto. Jo diçka, po më vike gjynah, thojsha e sheh qysh osht’ djali. Edhe kur kemi dalë mas dy mujve, jemi ulë ballë për ballë, në fakt unë jom konë ballë për ballë me babën e tij. Edhe t’u shku në takim i thashë babës tem, i thashë, “Babë” thashë, “nëse menon që s’të kom tregu najsen” thashë, “urdhno fol, a din, çkado që ki me më vet diçka”, “Jo” tha, “babë nëse ti ke harru me më tregu diçka fol” tha, “se njeri” tha, “ka momente që harron”. Thashë, “Mu s’po më kujtohet që kom harru najsen” thashë, “po fundja nëse thojnë ata diçka e unë e di që e kom harru” thashë, “tregoj që kom harru” a p’e din. “Okej”. Edhe dulëm na, dulëm në takim, në rregull.

Niherë fillun pak hajgare, “Qysh jeni, çka po boni?” Gjana shumë normal, sikur jeta osht’ t’u vazhdu në rregull. Edhe masanej baba jem tha, “Tash të folim realisht se s’jemi dalë me pi kafe për qef” tha, “po jemi dalë me bo ni zgjidhje për ni problem” tha, “që osht’ ni problem bajagi i madh” tha, “që ka me kushtu tanë jetën”. Kështu që, ju drejtu babës të atij, “Tani, ma shumë” tha, “me ty” tha, “kom muhabet” tha, “as me djalin tond, as me çikën tem, se këta jane fëmijë. Pavarësisht sa vjet i kanë bo” tha, “këta janë fëmijë. Se çika jem për mu osht’ fëmijë. Gjithë osht’ fëmija jem. Kështu që, unë me ty e kom ni muhabet si burri me burrin. Çka të ka bo” tha, “çika jem?” “Kurgjo”. “A të ka ronë me naj fjalë, a nuk të ka respektu?” Tha, “Jo, më ka respektu”.

“A nuk të ka bo hyzmet?” “Jo, s’ka pasë nevojë me thonë kurgjo se i ka kry krejt”. “E çka, a të ka ronë me naj fjalë a?” E realisht kur tha, “A të ka rënë me fjalë?” Ja dha ni përgjigje që unë tu e njoft babën tem e disha që e merr si me dyshim. Edhe ndërhyta, thashë, “Babë” unë apet ju ktheva me babë atij, thashë, “Babë, më fal që po ndërhyj” thashë, “po baba jem ta boni ni pyetje” thashë, “të kisha lut me ju

përgjigjë, tamam sinqerisht”. Thashë, “Se mënyra qysh ti ju përgjigje babës tem i ngjalli pak dyshime”, “Çka” tha, “me ju përgjigj?” “Babi ty po të vet, a të kom rënu me fjalë najsen”. Edhe u kthy tha, “Po ti s’ki kaqik me më rënu”. Une ja nisa me kesh, thashë, “Më mjaftoi përgjigja edhe babës tem i mjaftoi sigurt”. Edhe baba jem tha, “Për që s’ka kaqik” tha, “s’munesh me marrë me mend farë kaqika i ka”.

Po dal jashtë, baba gjithmonë më ka thirrë në emër të ni hallës tem, se ajo gjithmonë u konë ni asi tipi e urtë edhe përnime ka hjekë shumë. Edhe kur u pata feju une, se u ktheva tash pak mrapa, e kur u pata feju ja pat bo, “Më dhimet” tha, “se munët me hjekë, e me duru shumë, nuk e shprehë”. Edhe po thotë për hallën teme, “Krejt” tha, “osht’ si Mirveti. Qashtu ajo gjithë ka duru” tha, “ka hesht, e ka majt në veti. Tash” tha, “osht; mirë. Po çka tash i ka shku poshtë trupi” tha, “I ka shku poshtë jeta. Po, ani mirë tash i ka qit senet në vi, tash e ka jetën qysh duhet, po ka hjekë shumë” tha, “edhe kjo më dhimet” tha, “se nuk fol. Me shpreh me mu osht’ tjetër muhabet” tha, “po kjo nuk e shpreh as me mu, as me kërkon. E më dhimet. Kështu që, të lutna momentin që e shoh që çika s’osht’ mirë, ti ki problem diçka me to”.

Edhe i thotë atij, “Gjithë e kom krahasu me motrën tem se edhe ajo e ka qashtu edhe kjo osht’ qashtu” tha, “Prej pesë fëmijëve që i kom, për këto me më thonë dikush diçka vallahin bre nuk besoj. Jo ti, po gruja jem” tha, “me më thonë s’i besoj, e le mo ty” tha, “se e di çfare osht”. “Jo” tha, “as unë s’kom asni vërejtje”. Tha, “E çka pra, a e dini për çka lëshohet gruja?” Ja u ka bo. Tha, “A e dini?” tha, “Tri arsye jonë”. Ju ka kthy atij burrit tem tha, “A e ke nxon najsen që s’duhet?” “Prof” se prof i thojke, “Zoti mos e boftë” tha, “qysh po ta nxen goja atë fjalë me thonë?” Tha, “Jom në gjendje ku me ditë ku me shku me lonë veç vet edhe s’tutna”. “E a të ka rrejt?” “Jo”. “A të ka vjedh najsen?” “Jo”. “E çka? Leni këto sene të fëmive. Ti, a fëmijë je, a çka? A s’je konë në gjendje me kriju familje. Nëse s’je konë i gatshëm me kriju familje, pse ma ke marrë në qafë çikën tem? Pse s’je shku vëlla me marr ënë qafë dikon tjetër, po çikën tem? Çka osht’ t’u të bo kjo?”

Masanej kur e panë se s’kishin zgjidhje, u ftohën krejt edhe realisht gjithçka që u flitke, u flitke qashtu qysh unë i kom kallxu babës tem. Thashë, “Gjithmonë une kom vendos se baba jem më ka përkrah” thashë, “këtë herë po du me vendos baba e une me përkrah”. “Qysh” tha, “me vendos baba yt për neve dyve a?” Thashë, “Po”. Tha, “Ku ke pa?” Thashë, “Njejtë qysh vendosi nana jote për m’u nda na dy. Tash” thashë, “ka me vendos baba jem për mu bashku na dy”. Edhe p’e shohim babën tem, tha, “Kjo vendos, jo une” tha, “kjo po ma jep të drejtën amo osht’ jeta e saj, jo e jemja. Une” tha, “nuk ju nxo besë juve me ja u dhonë çikën teme në shpi të juve, se niherë çka m’i botë, e herën tjetër? Pse veç që ke smutë a, u deshke me çu te mjeku, me përdor terapi a? Me mjeku, e tash që koka shnosh pak te marrum, te kthejna a? Se kur osht’ keq duhet me çu te baba, e kur osht’ mirë me pru te na?”

Tha, “Cila osht arsyja? Plus asajna” tha, “edhe m’u kthy kjo te ju” tha, “edhe nja dy-tre mujë dej te merr veten, se hala osht’ tu u mjeku, hala osht’ me terapi e dej t’i kryen komplet. Tani” tha, “flasum. Megjithatë” tha, “e keni mundësinë” ja boni babës tij tha, “me i mledhë burrat” tha, “edhe më vjen te shpija me burra” tha, “edhe kur te shtin këtë punë burrat qatherë” tha, “çika jem” tha, “munët me

ardhë te ti”. “Jo” tha, “pse me shti, as s’e kena nisë këtë punë mes burrav, as s’pe shtina mes burrav”. “Jo”, tha, “s’e kemi nisë, po ju e keni pru punën qasi soji” tha, “se na ja kemi nisë shumë me të mirë. Kemi pasë qef me pasë raporte të mira mes veti”. Edhe baba i tij tha, “Une burra nuk tuboj kurrë. Kurrë në jetë” tha, “nuk tuboj burra”. Edhe aty, “Ta marrtë menja” tha, “hajde qe ku e ki”. Baba jem tha, “Tybe” tha, “unë ato sene” tha, “lehtë i boj” tha, “po i kom kry” tha, “do ditë shkollë” tha, “kom qef senet me i zgjidhë me fjalë, e jo me dhunë” tha, “se dhuna e para osht’. Meniherë”.

Tha, “Bile-bile ti s’kishe fol hiç me pasë shku senet me dhunë”, tha, “s’të kisha pritë” tha, “dy mujë une ty” tha, “po p’e shoh që s’ja vlen me fol mo. Po tjetra” tha, “që p’e shoh në krejt këto” tha, “na jemi qe dy orë të ulun këtu, as ky si babë, as ti si gjysh nuk je në gjendje me vetë qysh o djali. A ka me hongër, a ka me pi? A ka pampersa? A po keshë, a po kanë? A osht’ smutë, a osht’ mirë? Asnjoni s’keni vetë. Mos boni hajgare allahile. Nipi jem osht’ pjesë e çikës tem, osht’ pjesë e jemja, ai ka m’u rrit qysh u rrit çika jem. Bile-bile çikës teme i kanë mungu do kushte, këti s’ka me i mungu kurgjo. Mu po më vjen keq, po nipi jem ka m’u rritë pa dashninë e babës, qekjo ka m’i mungu. Une kom me ja ofru të gjyshit, e gjyshit s’ka me i mungu, a e babës po”. Qeto jonë konë fjalët e fundit edhe jemi nda. Ai ka ecë rrugës vet, une rrugës tem. Ai më ka thonë, “Kurdo që ta merr menja derën çelë e ki”. Mu s’ma ka marr mendja kurrë hiç.